

Thirrja është e hapur nga data 24.05.2024 deri me 31.05.2024

## TERMAT E REFERENCES

**Ekspert/e për hartimin e Planit të Veprimit Kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkollës 2024-2026, për Komunën e Prizrenit.**

Të dhënat mbi OJQ "Nevo Koncepti" dhe kërkesat për shërbimin e punëtorisë.

<b>Organizata</b>	<b>OJQ "NEVO KONCEPTI"</b>
<b>Objektiva</b>	<b>Hartimi i Planit të Veprimit Kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkollës 2024-2026, për Komunën e Prizrenit.</b>

### 1. TË DHËNAT MBI ORGANIZATËN

OJQ "Nevo Koncepti" është organizatë joqeveritare e themeluar më 26 Nëntor 2014. Në themelimin e OJQ "Nevo Koncepti" kanë marrë pjesë intelektualë të komunitetit Rom të cilët për shumë vite janë angazhuar në forma të ndryshme dhe kanë kontribuar në fuqizimin dhe avancimin e pozitës së komunitetit Rom në pjesë të ndryshme të Kosovës sikurse në Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Pejë, Rahovec, Fushë Kosovë, Suharekë etj.

OJQ "Nevo Koncepti" bashkëpunon me fëmijë, të rinjë dhe familje të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, me institucionet publike qendrore dhe lokale, organizata të shumta vendore dhe ndërkombëtare, media dhe palë tjera me interes.

Aktualisht OJQ "Nevo Koncepti" është duke zbatuar 5 projekte në fusha të ndryshme të cilat synim themelor kanë fuqizimin dhe përmirësimin e pozitës së komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

### 2. INFORMATA TË PËRGJITHSHMË RRETH PROJEKTIT

Aktualisht, "Nevo Koncepti" është pjesë e konsorciumit të përbërë nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS) dhe Drejtësi Sociale (DS). Ky konsorcium ka filluar zbatimin e projektit "Promovimi dhe Realizimi i të Drejtave të Romëve në Kosovë dhe në Shqipëri P7414". Projekti përkrahet dhe financohet nga *Ministria për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim e Republikës Gjermane (BMZ)*, *fondacioni Karl Kuebel Stiftung (KKS)* dhe *Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS)*. Grupi i synuar në Kosovë janë pjesëtarët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në shtatë komunat më të mëdha të Kosovës. Ndërkaq, fokusi i projektit do të jetë në katër fusha: Arsim, Punësim, Shëndetësi dhe Hartim Politikash.

### 3. OBJEKTIVA

OJQ Nevo Koncepti, kërkon të angazhojë një ekspert/e për hartimin e Planit të Veprimit Kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkollës 2024-2026, për Komunën e Prizrenit.

Qëllimi i planit të veprimit është koordinimi i veprimeve ndërinstitucionale dhe ngritja e kapaciteteve në nivel lokal dhe shkollor në zbatim të detyrimeve ligjore për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në shkolla, duke rritur përfshirjen e fëmijëve në arsim dhe zvogëlimin e braktisjes.

### 4. KUALIFIKIMET ARSIMORE, PROFESIONALE DHE PËRVOJA E PUNËS

- Diplomë Universitare (kualifikimi Master dhe edukimi profesional/joformal në fushën e të drejtave të fëmijëve, arsimit, vendimmarrje dhe avokim/politika lokale është përparësi);
- Dokumentimi i përvojës së punës së paku pesë (5) vite në hartimin e planeve të punës që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve, gjithëpërfshirjen dhe arsimin.

### 5. SHKATHËSITË E KËRKUARA

- Njohuri mbi mekanizmat dhe legjislacionin në fushën e arsimit parauniversitar;
- Njohuri mbi parimet e të drejtave të fëmijëve të bazuara në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës dhe njohuri mbi mekanizmat dhe legjislacionin nacional në fushën e mbrojtjes dhe të drejtave të fëmijëve
- Shkathtësi të shkëlqyera analitike, udhëheqëse dhe shkathtësi në shkrim dhe komunikim me zyrtarë institucional;

### 6. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

- Përgatitja e planit të punës dhe metodologjisë, draft-agjendën dhe zhvillimi i materialeve të nevojshme për punëtorinë me Ekipin për Pranadalimin dhe Reagimin kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkollës;
- Udhëheqja e punëtorisë treditore me Ekipin për Parandalimin dhe Reagimin kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkollës dhe hartimi i draftit të parë të planit të punës tre vjeçar me rekomandimet dhe sugjerimet e pjesëmarrësve;
- Dorëzimi i draftit të parë të planit të veprimit tek Nevo Koncepti, më së largu 7 ditë pas mbajtjes së punëtorisë, për rishikim nga Nevo Koncepti dhe KFOS.

## 7. AFATI KOHOR

Puna duhet të filloj me datën 06.06.2024 deri me datë 28.06.2024.  
Raporti duhet dorëzuar në gjuhën shqipe në përfundim të punës.

	<b>Tituli i rezultatit</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>Ditët e punës</b>	<b>Data e rezultatit</b>
1	Familjarizimi me politikat zhvillimore komunale, legjislacionin në fuqi dhe përgatitja e metodologjisë së punës për punëtorin.	Përgaditja e Materialeve si: metodologjia, agjenda dhe materialet tjera të nevojshme për hartimin e planit të punës.	1	6 qershor 2024
2	Mbajtja e punëtorisë për hartimin e planit të punës, përcaktimi i objektivave, rezultateve dhe aktiviteteve duke u bazuar në nevojat dhe propozimet që dalin nga vetë pjesmarrësit si vijon.	Ofrimi i punëtorisë treditore për Ekipin për Pranadalimin dhe Reagimin kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkollës.	3	7-8-9 qershor 2024
3	Përgatitja dhe dorëzimi i Planit të Veprimit për EPBRM dhe raportit narrativ.	Plani i Veprimit për EPBRM dhe raporti narrativ dorëzohen tek organizatat implementuese të projektit.	1	Më së largu deri me 17 qershor 2024
	<b>Gjithsej ditë pune:</b>		<b>5</b>	

## 8. REZULTATET E PRITSHME

- Zhvillimi i përmbajtjes së përgjithshme të planit të punëtorisë.
- Hartimi i Planit të Veprimit Kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkollës 2024-2026, për Komunën e Prizrenit.
- Stafi i NVK të jetë i informuar lidhur me procesin e punëtorisë.

## 9. PROCEDURA E APLIKIMIT

Të gjithë të interesuarit duhet ti dërgojnë këto dokumente:

- 1) Metodologjinë e punës për këtë angazhim, përfshirë planifikimin e mbajtjes së punëtorisë dhe hartimit të Planit të Veprimit Kundër Brakatisjes dhe Mosregjistrimit të Shkollës 2024-2026, për Komunën e Prizrenit.
- 2) Diplomë Universitare që dëshmon kualifikimin e tij/saj;
- 3) Curriculum Vitae (CV);
- 4) Propozimi financiar\*
- 5) Dokument i cili dëshmon që aplikuesi/ja nuk është nën hetime

Aplikimi duhet të dërgohet **jo më larg se data 31.05.2024** në [anesaberisha@nevokoncepti.org](mailto:anesaberisha@nevokoncepti.org) duke e kopjuar (cc) në email [o.osmani@nevokoncepti.org](mailto:o.osmani@nevokoncepti.org).